

**Konsolidimi i pasqyrave financiare të sektorit publik: për
njësitë e qeverisjes vendore dhe NSH**

***Monitorimi i performancës financiare të
ndërmarrjeve shtetërore në Mal të Zi dhe raporti
agregat***

**MINAS TRUBLJANIN,
MINISTRIA E FINANCAVE
MALI I ZI**

Ngritja e një sistemi për monitorimin e rreziqeve buxhetore të sektorit të NSH-ve

- ❑ Drejtoria për Monitorimin e Rreziqeve Buxhetore të NSH-ve është njësi organizative relativisht e re pranë Drejtorisë për Harmonizimin Qendror dhe Zhvillimin e Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm. Prej krijimit, gëzon **mbështetje të konsiderueshme nga FMN-ja**.
- ❑ Në 2022-2024, Ministria e Financave siguroi asistencë teknike dhe, në bashkëpunim me FMN-në, mori nismën “*Fuqizimi i mbikëqyrjes së ndërmarrjeve shtetërore*”. Deri më sot, janë kryer katër misione online, secili me rëndësi të konsiderueshme për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve ekonomike dhe analitike të Ministrisë.
- ❑ Në janar 2025, u zhvillua një mision i FMN-së në kuadër të projektit të FAD FMN “Reformat buxhetore në Evropën Juglindore”, Faza III (SEE III). Misioni u organizua me qëllim përmirësimin e operacioneve të ndërmarrjeve shtetërore, me fokus të veçantë te matja e rreziqeve thuajse-fiskale, dhe solli zhvillimin e një pasqyre të rreziqeve buxhetore duke përdorur platformën SOEHCT.

Ngritja e një sistemi për monitorimin e rreziqeve buxhetore të sektorit të NSH-ve

- ❑ Në bashkëpunim me FMN-në, dhe duke u mbështetur në platformën për përcaktimin e shëndetit financiar të ndërmarrjeve "SOEHCT" (Instrumenti i kontrollit të shëndetit të ndërmarrjeve shtetërore), ka pasur përparim të konsiderueshëm në rritjen e kapaciteteve institucionale përmes rritjes së aftësive praktike të punonjësve për identifikimin, analizimin, administrimin dhe zbulimin e burimeve të ndryshme të rreziqeve buxhetore.
- ❑ Konkretisht, në bazë të platformës për konstatimin e shëndetit financiar të ndërmarrjeve "SOEHCT" (Instrumenti i kontrollit të shëndetit të ndërmarrjeve shtetërore), janë përcaktuar pragjet e rreziqeve dhe kategorizimi i rreziqeve sipas koeficienteve, të cilat shkojnë nga **"KATEGORIA 1"** që tregon **rrezikun më të ulët** deri në **"KATEGORINË 5"** që tregon **rrezikun më të lartë**.
- ❑ Me instrumentin e kontrollit të shëndetit të NSH-ve, po përgatiten analiza financiare për të gjitha ndërmarrjet shtetërore nën mbikëqyrjen e Drejtorisë për Monitorimin e Rreziqeve Buxhetore të NSH-ve.



KRIJIMI I REGJISTRIT TË NSH-ve

- Në përputhje me rekomandimet e Komisionit të BE-së dhe konkluzionet së Malit të Zi, Ministria e Financave ka ngritur:
 - ✓ një ***regjistër të ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqërive ku shteti ka shumicën e aksioneve*** dhe
 - ✓ një ***regjistër të ndërmarrjeve komunale.***
- Të dy regjistrat janë publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë.
- Krijimi i regjistrave publikë të ndërmarrjeve shtetërore dhe komunale siguron transparencë në ushtrimin e aktivitetit ekonomik dhe të dhënat financiare të shoqërive ku shteti ose pushteti vendor ka shumicën e aksioneve.
- Kjo transparencë e shtuar pritet të sjellë rritje të llogaridhënies së nivelit drejtues, duke kontribuar kështu në një sistem më funksional planifikimi, monitorimi, raportimi dhe mbikëqyrjeje të këtyre ndërmarrjeve.

PËRMIRËSIMI I KUADRIT RREGULLATOR

- Ligji i ri për kontabilitetin*
 - Ligji i ri për auditimin*
 - Qeveria e Malit të Zi ka miratuar analizën e kuadrit institucional dhe rregullator për ushtrimin e aktivitetit të ndërmarrjeve shtetërore dhe shoqërive ku shteti ka shumicën e aksioneve.*
 - Është hartuar një Ligj i ri drejtimin e brendshëm të NSH-ve dhe politika për pronësinë shtetërore.*
 - Është hartuar strategjia për drejtimin e brendshëm të NSH-ve*
- Mbështetje e konsiderueshme nga ekipi i Bankës Botërore**

Raporti agregat

- ❑ Qeveria e Malit të Zi ka miratuar ***analizën agregate të performancës financiare të sektorit të ndërmarrjeve shtetërore për vitin 2023, së bashku me pasqyrën e rreziqeve buxhetore***. Analiza është mbështetur në rezultatet financiare të 50 NSH-ve dhe ka përdorur NSH-të.
- ❑ Kjo shënon **HERËN E PARË** që Mali i Zi ka publikuar një pasqyrë të tillë të rreziqeve buxhetore (fiskale) në përputhje me metodikën e FMN-së dhe në të ardhmen do ta përditësojë çdo vit dhe do të zgjerojë obektin e të dhënave, me qëllim përafrimin me praktikën e përparuar të FMN-së.
- ❑ ***Është hartuar analiza agregate e performancës financiare të sektorit të ndërmarrjeve shtetërore për vitin 2024, së bashku me pasqyrën e rreziqeve buxhetore***

Raporti agregat 2023



Të ardhurat vjetore të ndërmarrjeve shtetërore në Malin e Zi për periudhën 2018-2023 (milionë euro dhe % PBB)

Viti	Të ardhura vjetore të NSH-ve (milion euro)	Të ardhura vjetore të NSH-ve në % PBB	PBB në milionë euro*
2019	832,18	16,81	4.951
2021	818,13	16,51	4.955
2023	1.182,72	17,27	6.847

Shpenzimet vjetore të ndërmarrjeve shtetërore në Malin e Zi për periudhën 2018-2023 (milionë euro dhe % PBB)

Viti	Shpenzimet vjetore të NSH-ve (milion euro)	Shpenzimet vjetore të NSH-ve në % PBB	PBB në milionë euro*
2018	720,01	15,44	4.663
2019	776,87	15,69	4.951
2020	687,24	16,42	4.186
2021	823,84	16,63	4.955
2022	1.114,51	18,81	5.924
2023	1.022,10	14,93	6.847

Raporti agregat 2023



Agregati për NSH-të	2019	2020	2021	2022	2023
Të ardhura gjithsej	841,63	683,42	812,85	1140,96	1185,94
EBITDA	339,19	97,01	121,13	137,40	265,67
Fitimi neto	40,89	-10,55	-7,37	36,41	115,62
Totali i aktiveve	3832,97	3876,48	4327,79	4452,37	4712,54
Totali i aktiveve afatshkurtra	627,75	567,94	616,67	742,16	684,71
Totali i detyrimeve	915,31	828,57	912,89	1072,85	1080,40
Totali i detyrimeve afatshkurtra	417,92	320,01	393,13	501,20	476,72
Totali i kapitalit neto	2917,66	3047,91	3414,90	3379,52	3632,14

Raporti agregat 2023



Shpërndarja e NSH-ve në kategoritë e rrezikut për periudhën 2019-2023

Kategoria e rrezikut		2019	2020	2021	2022	2023
Kategoria 1	✓	1	1	1	2	2
Kategoria 2		15	14	13	10	17
Kategoria 3		14	7	17	17	14
Kategoria 4		6	16	15	18	12
Kategoria 5		7	6	3	1	3

SI I ZBUT MINISTRIA E FINANCAVE RREZIQET BUXHETORE NË SEKTORIN E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE

- ❑ Me përgatitjen e ***analizave së performancës financiare*** të sektorit të NSH-ve me anë të Instrumentit të kontrollit të shëndetit të NSH-ve dhe hartimin e ***pasqyrës së rreziqeve buxhetore***, qëllimi kryesor është të zvogëlohen shmangiet nga treguesit buxhetorë të planifikuar në Ligjin vjetor të buxhetit.
- ❑ Identifikimi në kohë i rreziqeve buxhetore i jep mundësi Ministrisë së Financave dhe Qeverisë të zbatojnë politikën buxhetore së bashku me propozimin e masave për të zbutur ndikimet negative në financat buxhetore.
- ❑ Duke pasur parasysh karakteristikat specifike të ekonomisë malazeze - një sistem i vogël dhe i hapur, shumë i ndjeshëm ndaj ndryshimeve të mjedisit gjeopolitik dhe ekonomik - si dhe pjesën dhe rëndësinë që zënë NSH-të në ekonominë e vendit dhe për qytetarët, thelbësore është ndjekja e një qasjeje proaktive për monitorimin e rreziqeve buxhetore. Në këtë aspekt, **rol qendror luan** veprimtaria e vazhdueshme e **Drejtorisë për Monitorimin e Rreziqeve Buxhetore të NSH-ve.**



PYETJE?

Kontakt:

Minas Trubljanin

Ministria e Financave

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria për Zhvillimin
e Harmonizimit Qendror të Kontrollit të
Brendshëm

Postë elektronike:

minas.trubljanin@mif.gov.me